



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

RREGULLORJA
MBI TATIMIN NË PRONË, PËR VITIN 2012

Dragash, 29.09.2011

Në bazë të nenit 9 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-049, nenit 11 të Ligjit për Tatimin Pronën e Paluajtshme nr.03/L-204 të datës 07.10.2010, nenit 12 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, Kuvendi i Komunës së Dragashit në seancën e vetë të mbajtur më 29.09.2011, miraton këtë:

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË PËR VITIN 2012

Dispozitat e përgjithëshme

Neni 1

1.1. Me këtë Rregullore caktohet tatimi mbi pronën e paluajtshme, caktohen standardet dhe procedurat që duhet respektua nga ana e komunës gjatë administrimit të kësaj takse.

Neni 2

2.1. "Pronë e paluajtshme" sipas kësaj Rregullore do të thotë toka dhe ndërtesat, stabilimentet dhe godinat në sipërfaqën e tokës dhe mbi sipërfaqën e tokës dhe që janë të lidhura me tokën. Në pronën e paluajtshme përfshihen njësitë brenda ndërtesave, si që janë banesat ose zonat për qëllime komerciale.

Neni 3

3.1. Tatimi mbi pronën caktohet për tërë pronën e paluajtshme, me përjashtim të pronës, e cila në përputhje me nenin 8 të Ligjit mbi Tatimin në Pronë është e liruar nga obligimi i pagesës së tatimit.

Neni 4

4.1. Obliguesi tatimor-tatimpaguesi është çdo person fizik apo juridik i cili është pronar i pronës së paluajtshme.

4.2. Në rastin kur pronari i pronës nuk mund të përcaktohet ose nuk mund të gjendet, tatimpaguesi është personi fizik ose juridik i cili e shfrytëzon ligjërisht ose mban pronën e paluajtshme.

Neni 5

5.1. Baza për llogaritjen e tatimit në pasurinë e paluajtshme do të jetë vlera e tregut e pronës .

5.2. Për çdo vit tatimor vlerë e tregut e cilësdo pronë është vlera e pronës më 31 dhjetor të vitit paraprak.

Neni 6

6.1. Tatimi mbi pronën do të grumbullohet sipas shkallëve tatimore:

1. Pronat e domosdoshme për qëllime banimi

a/ Për shtëpitë private 0,15%

b/ Për objektet banesore 0,15%

2. Pronat komerciale 0,20%

3. Pronat industriale 0,20%

Neni 7

7.1. Grumbullimi i tatimit në pronë bëhet sipas zonave tatimore dhe atë zona e parë, zona e dytë dhe zona e tretë.

7.2. Zona e parë përfshinë qendrën komunale të Dragashit

7.3. Zona e dytë përfshinë fshatrat

Bellobrad, Blaq, Bresnë, Brezne, Brod, Brrut, Buçe, Buzez, Gllloboqicë, Kapre, Kosavë, Krushevë, Kuk, Kukajan, Kuklibeg, Lybevisht, Mlik, Pllavë, Radeshë, Rapqë, Restelicë, Shajne, Vraniq, Zaplluxhe, Zgatar dhe Zym .

7.4. Zona e tretë përfshinë fshatrat Pllajnik, Xerrxe, Rrenc Baqkë, Dikancë, Orqushë, Zlipotok, Krs tec, dhe Leshtan.

Neni 8

8.1. Vlera e pronave përcaktohet sipas zonave të vlerësimit dhe janë të shprehura në € për 1 m² si vijon:

Zona e parë I-rë

1. Pronat e domosdoshme për qëllime banimi

a/ shtëpitë 250,00

b/ banesa 270,00

2.Pronat komerciale	500,00
2a/ Vlera e pronës për terrenet sportive të tipit të hapur përcaktohet në	45,00
2b/ Vlera e pronës për terrenet sportive të tipit të mbyllur përcaktohet në	60,00
3.Pronat industriale	450,00

8.2.Çmimet nga zona e parë aplikohen vetëm për qytezën e Dragashit.

Zona e dytë II-rë

1.Pronat e domosdoshme për qëllime banimi

a/ shtëpitë	200,00
b/banasa	220,00
2.Pronat komerciale	400,00
3.Pronat industriale	400,00

Zona e tretë III-të

1.Pronat e domosdoshme për qëllime banimi

a/ shtëpitë	170,00
b/banasa	200,00
2.Pronat komerciale	300,00
3.Pronat industriale	300,00

Neni 9

9.1.Të gjithë personat, të cilët posedojnë ose banojnë në një pronë të paluajtshme janë të obliguar që t'a regjistrojnë atë pronë në bazë të të dhënave për tatimin komunal të pronës dhe t'i ofrojnë komunës informacionin lidhur me pronën e paluajtshme, e cila i nënshtrohet regjistrimit me 1 mars ose para 1 marsit të çdo periudhe tatimore.

9.2 Të gjithë personat, të cilët posedojnë, shfrytëzojnë ose marrin një pronë të paluajtshme në shfrytëzim, duhet t'i lejojnë zyrtaret e autorizuar që përfaqësojnë autoritetin komunal të tatimit në pronë, të hyjnë në tokën dhe në ndërtesat e tyre gjatë orëve të ditës për t'i mbledhur të dhënat lidhur me pronën.

Neni 10

10.1 Funkcionet e komunës sa i përket administrimit të tatimit në pronë janë:

- a/ menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën,
- b/ vlerësimi i pronës,
- c/ përgaditja dhe lëshimi i faturave të tatimit
- d/ inkasimi dhe inkasimi i detyruar i tatimit mbi pronën dhe
- e/ankesat administrative.

10.2 Baza e të dhënave mbi pronën bazohet në regjistrin e të drejtave mbi pronën dhe katastrin e tokës. Zyra Katastrale komunale siguron bazën e të dhënave mbi pronën dhe informacionet e nevojshme nga regjistri.

10.3 Komuna e përcjell vlerën e tregut të çdo prone që është nën juridiksionin e sajë.

10.4 Fatura për tatimin në pronë lëshohen nga baza e të dhënave deri më 31 mars ose para 31 marsit të secilit vit.

10.5 Ministria e Financave, duke shfrytëzua praktikën e viteve të më parshme merr pëlqimin e komunës që mund të lidhë marrveshje me PTK-ën për përgatitje, printimin, zërfimin dhe dërgimin e faturave deri te obliguesi tatimor me çmime të cilat më parë i bëhen të ditura komunës.

10.6 Pagesa e tatimit në pronë bëhet në dy këste të barabarta më 30 qershor dhe më 31 dhjetor.

10.7 Për mos pagesën e tatimit në prone, sipas afateve të përcaktuara, do të llogariten kamata ndëshkuese në baza mujore. Kamata llogaritet nga data kur duhet të paguhet tatimi deri në datën kur është pagua tatimi.

Neni 11

11.1 Komuna, duke pas parasysh gjendjen e vështirë financiare të tatimpaguesit, mund të lejojë tatimpaguesit që ta shtyjë pagimin e tatimit në pronë me kusht që shtyrja të vlejë për një faturë tatimore e cila kufizohet për një afat kohor që nuk tejkalon dy vite.

11.2 Tatimpaguesi që dëshiron shtyrjen e pagesës së tatimit në pronë duhet të paraqes dëshmi të saktë të cilat mbështesin kërkesën e tijë.

Neni 12

12.1 Çdo obligues tatimor ka të drejtë ankese nëse konsideron se nuk është bërë vlerësimi i drejtë i pronës së tijë ose ndonji parregullësi tjetër lidhur me pronën në bazën e të dhënave.

12.2 Kërkesa mbi shqyrtimin e faturës mbi pronën i drejtohet Bordit komunal për ankesa. Kjo kërkesë duhet të parashtrahet Bordit për shqyrtim në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës duke u përcjell me dëshmi mbështetëse që dëshiron të paraqes tatimpaguesi.

12.3 Kërkesa e tatimpaguesit për shqyrtimin e faturës tatimore nuk pezullon obligimin për t'a paguar tatimin.

12.4 Bordi komunal për ankesa Brenda 60 ditësh do të njoftojë parashtruesin e ankesës – tatimpaguesin për vendimin e tijë.

Neni 13

12.1 Çështjet të cilat nuk janë përfshir në këtë Rregullore do të aplikohen nga Ligji për Tatimin në Fronën e Paluajtëshme..

Neni 14.

13.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore ,pushon të jetë në zbatim Rregullorja mbi tatimin në pasurinë e paluajtshme ne teritorin e komunës së Dragashit 01 nr.06-430/2 prej 30.09.2010.

13.2 Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi I komunës , ndërsa do të zbatohet nga 01.01.2012.

Neni 15

14.1 Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim -Njësija për tatim në pronë.

Dragash,29.09.2012
01 Nr. 06-2027/2

KRYESUESI I KUVENDIT
Lulzim Rifaj

